



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

F T O J

Mbledhjen e tretë e Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më **15.06.2020** (e hënë) duke filluar në orën **11:00**.


R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Njoftim nga Këshilli Komunal emergjent rreth situatës gjatë pandemisë me COVID19;
3. Njoftim nga Drejtoria e bujqësisë rreth procedurave të subvencionimit në bujqësi nga Komuna e Novobërdë;
4. Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore te zyrës;
5. Të ndryshme;

Me: 08.06.2020
Në: Novobërdë



Shpresa Kqiku
Kryesuese e Komitetit për Komunitete



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dytë e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 13.02.2020, duke filluar në orën 11:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Dobrivoje Djordjovic, Aleksander Pavic, Zymer Zymeri, Abdyl Gashi, Jorgovanka Filic, Zv.kryesuesi i Kuvendit Ramush Mehmeti, ZKKK Sami Vllasaliu dhe përfaqësuesit i OSBE-së.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshendeti të pranishmit e hapi mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Njoftim nga DAK rreth fillimit të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2019/20;
3. Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore;
4. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a kan ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend dite?

Pasi nuk pati propozime aprovohet njëzëri rendi i ditës nga anatrët prezent të Komitetit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;

Kryesuesja e hapi diskutimin rreth kësaj pike.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet njëzëri nga të gjithë antarët prezent procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Pika e dytë: Njoftim nga DAK rreth fillimit të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2019/20;

Kryesuesja tha: për arsye se raporti për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë nuk është i kompletuar propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Të gjithë antarët u pajtuan që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Pika e tretë: Informim nga zyra për komunitete rreth aktiviteteve mujore;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën ZKKK Sami Vllasaliut.

Sam Vllasaliu pasi përshendeti të pranishmit tha: kerkoj falje në emer të shefes së zyres pasi që ka pasur një takim dhe nuk ka pasur mundësi që të merr pjesë, gjatë kësaj periudhe kohore janë kryer këto punë dhe detyra: kanë marr pjesë në një vizit në Serbi ku janë vizituar 18 familje, kemi pasur vizita në teren me organizaten e DRC-së ku janë vizituar 6 familje ku janë vlersuar kushtet e këtyre familjeve, po ashtu jemi në vazhdim të realizimit të projektit DRK5 në fazën teknike dhe njëkohësisht kemi paraqitur rastet e reja që do të përfshihen në këtë projekt, poashtu jemi duke punuar në përgaditjen e veper koncertit me organizaten e UNHACER-it për gjithësej 20 familje, njëkohësisht është bërë regjistrimi i 5 familjeve që janë lajmëruar në zyren tonë, jemi në implemtinin e projektit të DRC-së pra projekti ka të bëjë me funizimin e inventarit në shtepinë e kultures në Koretishtë, kemi pasur takime të rregullta me Ministrinë e Kthimit dhe organizata të ndryshem si UNHACER-it dhe IOM-it, UNMIK-ut, lidhur me kordinimin e aktiviteteve dhe detyrave që na presin këtë vit, kjo sa i

perket detyrave dhe punëve që kemi kry. Kam edhe një qështje tjetër ta paraqes para jush pasi që në kuader të detyrave që ushtroj mirrem edhe me menaxhimin e personave të riatdhesuar andaj kerkoj që në rend të dities të hyn edhe plani për personat e riatdhesuar pasi që nuk është aprovuar në mbledhje të Kuvendit, përafersisht numri i personave të riatdhesuar në komunën tonë është 90, 90% e këtyre personave i takojnë komunitetit Shqiptarë dhe perqindja tjetër komuniteteve tjera, ne më këta persona punojmë në bazë të këtij plani, mendoj se duhet tju ndihmojmë këtyre personave dhe kemi obligim që tju ndihmojmë, po ashtu ju njoftoj se ky është një nga kriteret e MSA-së që të gjitha Komunitatet e Kosovës ta aprovojnë një plan të tillë dhe në takimin e fundit që kemi pasur me Ministrin e Punëve të Brendshme të jeni të bindur se jemi Komuna e vetme që nuk e kemi aprovuar, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobriboje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: personi i vetëm i cili kam qenë i vetpermbajtur kam qenë unë për këtë plan, po e paraqes qëndrimin tim për zyrën e kthimit që punojnë për personat e rikthyer, nuk kam të drejtë ta gjykoj as ta kuzhëzoj askend por duke e pas parasysh se njerëzit të cilët kanë perfituar nuk janë ata që kanë pas nevojë, ka persona që kanë shkuar 2-3 muaj e pastaj janë kthyer si persona të riatdhesuar nga Serbia për këtë arsye kam qenë i përmbajtur nuk kam dashur ta gjykoj askend po nese Kuvendi i bie këtë vendim më shumicë e përkrahi, ju faleminderit.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: temën që e diskutoj Samiu na nxiti të flasim, komiteti për komunitete është obligativ dhe obligative është që të dergoj pika në Kuvend varësisht prej kërkesave të komitetit dhe pozita ime si zv.kryesues është që nese Kuvendi një pikë e refuzon kam të drejtë me kthi mbrapa mirëpo arsyet po shihen pasi që unë si zv.kryesues kur kam kërkuar listen e projekteve prej komitetit me emra dhe mbiemra dhe kur ka qenë plani se kanë mu ndertu disa shtëpi 10-15kam kerku listen se kush ka perfitu por kurr ska ardhur ajo list, ndërsa janë obligativ që ta sjellin liste, kur e kam parë se ajo list nuk po na prezantohet dhe për këtë arsye kam qenë kunder kur nuk e di planin nuk e di se kush po perfiton.

Sami Vllasaliu tha: të sqarohet pasi që ju më shumë po i keni vërejtjet për planin aksional për kthim ndërsa unë prezantova planin për riatdhesim, të gjitha vërjetje i keni për planin për kthim, kolegu tha se po kthehen personat prej Serbis ne me rregullore nuk kemi të drejtë të regjistrojmë persona të kthyer prej Serbis si persona të riatdhesuar, atë që e tha Ramushi listen se çka kanë perfituar këta persona, personat e riatdhesuar deri në vitin 2016 që kam ardhur unë në këtë detyrë nuk kanë perfituar asgjë ndonjë herë vetëm disa paketa me gjëra ushqimore, pas ardhjes time kanë perfituar 5 familje dhe ata kanë perfituar përmes zyres së punësimit pasi që ne nuk kemi të drejtë ti financojmë, projektet kanë qenë paisje për ndertimatri, për autolarje etj, nese e shihni të arsyeshme ju sjell edhe listen se kush ka perfituar por me rregullore të tërë aplikimi bëhet përmes zyres së punësimit, ne jemi për tju ndihmuar këtyre personave në përmirësim të kushteve, në të ardhmen mundë të kenë përparësi në aplikim të granteve, andaj kerkoj nga ju që të ndikon edhe të të tjerët që këto plane të përkrahen, ju faleminderit.

Dobriboje Djordjevic tha: planin e kthimit e kam votuar kunder ndërsa planin e riatdhesimit kam apstenu, kemi rastin në vitin 2010 është kthyer si i riatdhesuar ka perfitu edhe pastaj është kthye.

Sami Vllasaliu tha: ky program egziston prej vitit 2013 më heret nuk ka egzistuar ai ndoshta ka perfituar por duhet ditur se prej cilit programa a ka perfituar nga programi i kthimit?.

Ramush Mehmeti tha: atë ditë kanë qenë dy pika dhe të dy pikat janë votuar kunder, çdo list, çdo perfitues duhet ditur se kush është, nese vjen lista në Kuvend se kush ka perfituar ne do ta votojmë planin por nese propozohet plani dhe lista nuk është unë them se perseri nuk kalon.

Sami Vllasaliu tha: unë ju sjell listen prej mandatit që jam unë, por ta keni të qartë që selektimin se kam bërë unë por zyrja e punësimit, kur është bërë shpallja kanë aplikuar të gjithë personat e riatdhesuar, unë përmes Valmires ju dergoj listen e perfituesve.

Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: të gjithë që kanë aplikuar nuk mundë të perfitojnë, 90 persona nuk ke mundësi ti dish se kush ka perfituar.

Sami Vllasaliu tha: 82 persona janë të kthyer dhe do tju dergoj listen me emer dhe mbiemer se kush janë të kthyer, të gjithë këta persona kanë të drejt të aplikojn kur ka shpallje mirëpo prej tyre ka mundësi që të perfitojn vetem 5.

Zymer Zymeri tha: unë se kisha përkrah që çdo herë të perfitojnë personat e njejt.

Sami Vllasaliu tha: ajo nuk varet nga ne pasi që tjetër kush i perzgjedh, ne si Komunë permes këtij plani kemi mundësi që tju ndihmojm këtyre personave rregullimin e dokumentave, komuna kur të shperndan subvencione këta persona me pas përparsi, si dhe kur shpall konkurse për punë me pas përparsi, dmth qëllim i këtij plani është me ju bë kushte këtyre personave që mos të largohen.

Zymer Zymeri tha: unë nuk e votoj as këtu as në Kuvend për arsye se ka raste që e kan shit këtu shtepin kanë shkuar në Gjermani, është kthyer pas 2 muajve dhe vjen këtu kerkon ndihm dhe nuk aplikojn te ju për në zyre të punësimit.

Sami Vllasaliu tha: kjo strategjia është strategji kombëtare dhe Qeveria e ka bërë që mos të aplikojn në Komunë por në Ministrinë për Punë dhe Mirqenie Sociale, ata e hapin shpalljen dhe këta persona aplikojn atje në zyre të punësimit dhe komisioni vendos për përzgjedhjen.

Aleksander Pavic pasi pershendeti të pranishmit tha: diskutimi ka qenë shumë interesant , e kam një pyetje personat që janë kthyer me dhunë prej shteteve të ndryshme a llogariten edhe ata persona të riatdhesuar?.

Sami Vllasaliu tha: po edhe pse shumica thojnë që vullnetarisht jemi kthyer e dim se janë kthyer me dhunë.

Kryesuesja tha: a pajtoheni që këtë pikë ta dergojm në Kuvend?

Dobrivoje Djordjevic tha: nese e marim obligim që kjo pikë të shkoj në Kuvend, atëher ti si Kryesuese e Komitetit duhet ta dergosh në Kuvend jo permes sekretares së Kuvendit.

Aprovohet njëzëri kjo pikë nga të gjithë antarët prezent që të shkoj në Kuvend

Pika e katërt: të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 11:45.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku
Kryesuese i Komitetit për Komunitete

